



Departamenti i Prokurimit

Prishtine: datë,26.10.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 23.10.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik **n.t.sh Dino & Ceni Group shpk**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i Tri Shkollave Të Reja, Sigurimi i Mirëmbajtjes dhe Ofrimi i Shërbimeve në Komunën e Prishtinës, Republika e Kosovës", me Nr. të Prok:

616	2	0	1	0	7	5	1	2
-----	---	---	---	---	---	---	---	---

nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik **n.t.sh Dino & Ceni Group shpk** të dt. 23.10.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit " **Ndërtimi i Tri Shkollave Të Reja, Sigurimi i Mirëmbajtjes dhe Ofrimi i Shërbimeve në Komunën e Prishtinës, Republika e Kosovës**, me Nr.616-20-107-512 kundër **Njoftimit për kualifikim të OE**.
2. **Vërtetohet** vendimi i AK për Kualifikimin e OE të publikuar me datë: 20.10.2020;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit*;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të ju dërgohet të gjithë OE te cilet kane dorezuar aplikacionet ne pergjigje te Kekreses per Parakualifikim.

Arsyetim

Operatori Ekonomik n.t.sh Dino & Ceni Group shpk me datë 23.10.2020, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: 'Ndërtimi i Tri Shkollave Të Reja, Sigurimi i Mirëmbajtjes dhe Ofrimi i Shërbimeve në Komunën e Prishtinës, Republika e Kosovës, me Nr.616-20-107-512 kundër Njoftimit për kualifikim te OE. Autoriteti Kontraktues, me datë 26.10.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

KERKESAT e PARASHTRUARA ne Dokumentet e parakualifikimit

Ne pjesen I, te Dokumenteve te Parakualifikimit , respektivisht ne pjesen "Udhëzime per Aplikuesit" pika 16 percaktonte:

16. Dokumentet të cilat përbëjnë Aplikacionin

16.1 Aplikacioni duhet të përmbaje si në vijim:

- a) Formularin e Dorëzimit të Aplikacionit duke përdorur formularin 3A dhe 3B siguruar në Pjesën III të këtij Dokumenti Para-kualifikues;
- b) Dokumentet dëshmuese në përputhje me Udhëzimet për Aplikuesit Seksioni 5 evidentimi i përshtatshmërisë së Kandidateve; (Aneks 3 C., 3 D);
- c) Dokumentet dëshmuese në përputhje me Udhëzimet për Aplikuesit Seksioni 7, evidentimi i gjendjes ekonomike dhe financiare të Aplikuesit, Aneksi 3.F;
- d) Dokumentet dëshmuese në përputhje me Udhëzimet për Aplikuesit Seksioni 8, evidentimi i aftësive teknike dhe profesionale të Aplikuesit Aneksi 3E;
- e) Dokumentet dëshmuese në përputhje me Udhëzimet për Aplikuesit Seksioni 10 dhe 11, nëse aplikohen, dhe 3.B.1 – Organizata e Aplikuesit, 3.B.2 – Formulari për informatat themelore, 3.B.3 Kërkesat për Grupin e EO, 3.B.4 – Autorizimi, 3.B.5 Autorizimi (nëse aplikohet)
- f) Ndonjë dokument tjetër që **kërkohet në FDP**.

Aneksi 3 i Dokumenteve te Parakualifikimit percaktonte:

Aneksi 3. Formularët standardë të Aplikimit

Faqet në vijim përmbajnë formularët standardë për parashtrimin e Përgjigjes.

Aneksi 3.A	Formulari i parashtrimit të përgjigjes
Aneksi 3.B	Organizata e Aplikuesit
	Formulari 3.B.1 Organizata e Aplikuesit
	Formulari 3.B.2 Formulari për informacione themelore
	Formulari 3.B.3 Marrëveshja e Grupit të OE
	Formulari 3.B.4 Autorizimi
	Formulari 3.B.5 Autorizimi, nëse është i aplikueshëm
Aneksi 3.C	Deklarata nën betim në lidhje me pranueshmërinë ligjore
Aneksi 3.D	Kriteret e pavarësisë

	Formulari 3.D	Dëshmia e pavarësisë
Aneksi 3.E	Kriteret teknike	
	Formulari 3.E	Përvoja Minimale në Projektim-Ndërtim-Financim të
	Infrastrukturës	
Aneksi 3.F	Kriteret financiare	

Formulari 3.B.3, përcaktonte kushtet si ne vijim, e nje nder ta ishte eshte kushti (v) ,i cili kusht nuk eshte permbushur nga ana e juaj sepse askund ne dokumentet e dorezuara nuk eshte deklaruar pika (v)

Formulari 3.B.3 Kërkesat për Grupin e EO

[Në rastin e Grupi i OE, Aplikuesi duhet të dorëzojë një kopje të nënshkruar origjinale të dokumentit ligjërish obligues që themelon Grupin e OE ("Marrëveshja e Grupi të OE"). Marrëveshja e tillë e Grupi i OE duhet të noterizohet ligjërish dhe të nënshkruhet nga një zyrtar i autorizuar i secilit Pjesëtar të Grupi i OE, si dhe të përfshijë, më së paku, pikat vijuese:

- (i) Identitetin e të gjithë Pjesëtarëve të Grupi i OE dhe rolin e tyre të pritur në rast se Grupi i OE fiton kontratën;
- (ii) Emërimi i Pjesëtarit Kryesor të Grupi i OE;
- (iii) Autorizimi i Pjesëtarit Kryesor që të veprojë në emër të Grupi i OE dhe në emër të të gjithë Pjesëtarëve të Grupi i OE për çështje të lidhura me këtë Prokurimi;
- (iv) Njohje e shprehur që Pjesëtarët e Grupi i OE do të mbajnë përgjegjësi individuale dhe solidare ndaj Autoritetit Kontraktues për përmbajtjen e Aplikacionit të Grupi i OE; si dhe
- (v) Deklarimi nga të gjithë Pjesëtarët e Grupi i OE që në rast se Grupi i OE bëhet Tenderuesi Zgjedhur, Grupi i OE do të obligohet që ligjërish të formatizojë marrëdhëniet ndërmjet pjesëtarëve përmes themelimit të një entiteti të pavarur ligjor sipas ligjeve të Kosovës.]

Pretendeimi i OE

1. Shkelje e nenit 7 te LPP
2. Deklarimi i OE: "Ne kemi sqaruar se kemi permbushur detyrimet nga ana e jone ne lidhje me formularin e oferets 3.B.3, pika V , e cila ka te beje "Deklarimi nga të gjithë Pjesëtarët e Grupi i OE që në rast se Grupi i OE bëhet Tenderuesi Zgjedhur, Grupi i OEdo të obligohet që ligjërish të formalizojë marrëdhëniet ndërmjet pjesëtarëve përmes themelimit të një entiteti të pavarur ligjor sipas ligjeve të Kosovës", është plotësuar mbi bazën e akteve të bashkangjitura në DT "Consortium- Marrëveshjes së Partneritetit dhe Deklaratës, përmes të cilave akte janë të rregulluara/inkorporuara të gjitha detyrimet financiare dhe ligjore lidhur me implementimin e projektit në fjalë sipas kërkesave të formularit 3.B.3 pika V.

Arsyetimi

1. **Neni 7 (Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi)** - sipas këtij neni AK është i obliguar që do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese, gjë të cilën AK e ka respektuar, duke trajtuar të gjithë OE në mënyrë të barabartë dhe në të njëjtën kohë thekson se nuk keni dhënë asnjë argument se është shkelur kjo dispozite. Prandaj, pretendimi i OE lidhur me shkelje të nenit 7 hudhet poshtë si i pabazuar sepse AK, ka vepruar në mënyrë të njëjte me të gjithë OE. Të gjithë OE të kualifikuar kanë dorëzuar Deklaratën e kërkuar.
2. AK, ka përfunduar vlerësimin e aplikacioneve në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Dokumentet e Para kualifikimit.
 - ✓ Dokumentet e dorëzuar nga ana e Juaj nuk përmbanin deklaratën e përcaktuar në Aneksin 3.B.3.
 - ✓ Megjithatë, në përputhje me nenin 72 të LPP-se, respektivisht nenin 39 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të PP, Komuna e Prishtinës ka kërkuar sqarim shtese me datë 01.10.2020.
 - ✓ Në përgjigjen e juaj, keni deklaruar se ju keni përmbushur kërkesat dhe se të gjitha kërkesat janë plotësuar me deklaratat e përcaktuara në Marrëveshjen e Partneritetit
 - ✓ Në kërkesën për rishqyrtim, deklaroni se të gjitha detyrimet financiare dhe ligjore lidhur me implementimin e projektit në fjalë sipas kërkesave të formularit 3.B.3 pika V, janë të Deklaratës.
 - ✓ **AK, vlerëson se një deklaratë e tillë nuk figuron në Consorcium - Marrëveshje e Partneritetit, prandaj Komuna me të drejtë ka eliminuar aplikacionin tuaj mbi bazën administrative.**

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit